ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS (AMKMK)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **253-22-9179-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare-Gjakovë-Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**LIMITPROJECT SH.P.K.**
NUI	**811312561**
Adresa	**Skenderbeu Q.Zej.E-3-5, .**
Vendi	**Gllogoc**
Kodi postar	**13000**
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Lulzim Zaraj**
Adresa elektronike	**limitproject.shpk@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**28.03.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare-Gjakovë-Ritender

1. Procedura e prokurimit, sipas Dosjes se Tenderit është përgatitur me datë 02.09.2022

2. Afati i hapjës se ofertave, sipas Dosjes se Tenderit ishte 19.09.2022

3. Autoriteti Kontraktues me datë 02.11.2022 ka publikuar Njoftimi mbi vendimin – F, B58

4. Me datë 02.11.2022, kemi si GOE aplikues kemi pas çasje të pjesshme në Dokumente Zyrtar

5. Sot me datë 07.11.2022, si GOE po paraqesim Kërkesën për rishqyrtim në AK – F02

6. Me datë 18.11.2022, AK nxjerr vendim për refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim të datës 07.11.2022

7. Me datë 21.11.2022, e kemi shfrytëzuar të drejten ligjore për Ankimi në Organin Shqyrtues të Prokurimit OSHP

8. Me datë 01.02.2023, e kemi pranuar vendimin nga OSHP lidhur me ankesën 689/2022.

9. Me datë 10.03.2023, kemi pranuar Njoftimin mbi vendimin e AK – mbi pretendimet për anulium

10. Me datë 13.03.2023, kemi paraqitur Kërkesën për rishqyrtim pranë AK, si rezultat që pretendojmë se po shkaktohet padrejtësi.

11. Me datë 23.03.2023, kemi pranuar Vendimin për refuzimin e kërkesës sonë.

12. Me datë 28.03.2023, po paraqesim Ankesën pranë OSHP-së mbi vendimin e AK, si rezultat që pretendojmë që po shkaktohen padrejtësi.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Të bashkangjitur i gjeni (përpos dokumentave tjera):

1. Kërkesën për rishqyrtim të datës 07.11.2022, kundrejt Njoftimit Mbi vendimin e AK për procedurën e prokurkimit: Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare – Gjakovë - Ritender me numër të prokurimit: 253-22-9179-5-1-1 (AMKMK-22-034-511).

2. Vendimin për shqyrtimin e Kërkesës për rishqyrtim – të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues me datë 18.11.2022.

3. Opinionin e lëshuar nga KRPP lidhur me çasjen në dokumente zyrtare dhe sekretet afariste.

4. Vendimin e OSHP-së / konkretisht: 689/710/22 lidhur me trajtimin e lëndës: Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare – Gjakovë - Ritender me numër të prokurimit: 253-22-9179-5-1-1 (AMKMK-22-034-511).

5. Kërkesën për rishqyrtim të datës 13.03.2023, kundrejt Njoftimit Mbi vendimin e AK për procedurën e prokurkimit: Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare – Gjakovë - Ritender me numër të prokurimit: 253-22-9179-5-1-1 (AMKMK-22-034-511).

6. Vendimin për shqyrtimin e Kërkesës për rishqyrtim – të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues me datë 23.03.2023.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Si Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; BM Group SH.P.K.; N.T. „Fer-Petroll, Skenderbeu Q.Zej.E-3-5, ., 13000, Gllogoc, Kosovë, pretendojmë se ka shkelje të Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, në nenet e me poshtme:

Neni 1. Qëllimi

Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 11. Informatat Sekrete Afariste

Neni 24. Zyrtarët e prokurimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit

Neni 54. Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar

Neni 59. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62. Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Pretendojmë se ka shkelje edhe të Legjislacionit sekondar A01 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (rregulla këto mbi të cilat është rregulluar procedura e prokurimit "Ekzekutimi i Punëve - Ndërtimi i Fazës së Katërt "Beteja e Koshares", Koshare-Gjakovë-Ritender) me numër të prokurimit 253-22-9179-5-1-1 (AMKMK-22-034-511)", shkeljet janë të paraqitura me poshtë:

1. **Fushëveprimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ**

3. Qëllimi i Rregullave dhe Udhëzuesit

41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

43. Njoftimi i Tenderuesve / Kandidatëve

44. Ndërprerja e procedurave të prokurimit

Jemi të vetedijshem se nga data 01.11.2022 ekziston një rregullore e veçantë e cila e ka shfuqizuar rregulloren e paraqitur me lartë, por fakti që procedura është e hapur me datë 02.09.2022 si GOE shfrytëzojmë të drejten ankimuese brenda AK duke u bazuar në RrUOPP.

Autoriteti Kontraktues - Agjencia për Menaxhimin e Kompleksev Memoriale të Kosovës (AMKMK), ka shkelur edhe dispozita tjera të LPP-së dhe RrOUPP-së gjatë dhe në trajtimin e Kërkesës për rishqyrtim; 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, konkretisht piken 6 dhe 12.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kërkesa për rishqyrtim është e ndarë në tre (3) pjesë:

Pjesa e parë: Anulimit të procedurës / si pretendime të pabazuara.

Pjesa e dytë: Eliminimi edhe Operatoreve të tjerë ekonomik (konkretisht Operatoreve 1 - Grupi i Operatoreve Ekonomik SHKEMBI GLLAREVE SH.P.K; AD-STAR SHPK; BENI COM SH.P.K. PRO&CO GROUP, KLINË 32000, DRESNIK, nuk plotëson:, 2 dhe 3 në listë, të njejtit janë përjashtuar nga konkurimi me vendimin e Panelit Shqyrtues, andaj pretendimet i paraqesim vetem për Operatorin 1 / i renditur si OE me i lirë).

Pjesa e tretë: Trajtimi i ankesës se Grupin e Operatoreve Ekonomik Sinani ING SHPK; EL-BAU SHPK; Benita Company; BHSPartners SHPK, Bulevardi i Dëshmoreve, nr. 72, Kati I-rë, 10000 Prishtinë;

Pjesa e parë: Pretendimi i anulimit të procedurës / si pretendime të pabazuara

-

Në mënyrë të terthort AK kthen përgjigje të përgjithshme duke jap një kronologji të veprimeve ani pse i njejti nuk e paraqet asnjë dëshmi lidhur me këtë çështje (ato se çfarë i thot në vendim). I njejti thekson se projekti është planifikuar te realizohet me 31.12.2024 (dhe të filloi me 03.10.2023) nëse e analizojme me muaj janë 26/27 muaj sa qe i bije se kjo procedure (nga vendimi i ti) do të shtyhet se realizuari deri me mesin e vitit 2025 (dhe nëse analizohet buxheti për këto muaj dhe në Buxhetin e Republikës se Kosovës) i bije se kjo procedurë ka mjete të mjaftueshme për realizim. Lidhur me pretendimet tona për anulimin e pabazë të procedurës, i kemi ngritur 4 pretendime, ku per asnjerin prej tyre AK nuk ka nxjerr konkluzion për pretendimet tona.

Pretendimi numër 1.

Duke e ditur që procedura është e ngritur në platformë para datës 01.11.2022, si OE po paraqesim se duke u mbeshtetur në Rregulloren dhe Udhezuesin Operativ për Prokurim Publik RrUOPP, konkretisht nenin 44 i cili specifikon nderprerjen e procedurave të prokurimit, konkretisht pika 44.6 thekson se procedura e prokurimit pas hapjes se ofertave ***"44.6. Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: (i) të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK"...*** pra, kjo çështje tani me është e mbyllur, pasi që me vendimin e Panelit Shqyrtues të OSHP-së i kanë dhënë të drejtë ankesës sonë dhe si i tillë anulimi i procedurës pas hapjës se ofertave mund të anulohet vetem në rastin kur OE janë të papergjegjshëm.

Pretendimi se AK ka duke u bazuar në rregulloren e re, e cila ka hy në fuqi me datë 01.11.2022 është i pabazuar për faktin që procedura është ngritur apo inicicuar me rregulloren e vjetër. Po ashtu, nuk mund të llogaritet se një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi / për faktin që mos mbetja e vlerës financiare nuk është shkelje ligjore, shkelje ligjore do të mund të llogaritet në rastin kur AK e ka nisë / inicuar apo ngritur procedurën në fjalë pa pas mjete në KASH, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

zuar në këtë rregullore e re, asnjë dispozitë ligjore e as akte tjera administrative, konkretisht neni 43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e

mëposhtme:

a) asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

b) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;

c) numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);

d) nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

e) numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;

f) nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

g) asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

h) nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

i) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

j) nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i paripareushëm; ose

k) nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i paripareushëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Në asnjë nga pretendimet e pikës 1, AK nuk kthen përgjigje. Analizo, i njejti thirret ne atë se një shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo kjo nuk mund të llogaritet shkelje ligjore sepse mungesa e fondeve (nuk do të thot mos realizim / sigurim i fondeve në të ardhmen). Detaje shtesë: **Shihet qartë se nuk specifikohet se procedura mund të anulohet në rastin kur mjetet ishin në dispozicion dhe me deshirën e AK një gjë e tillë nuk është në funksion me.** Po ashtu, duke e ditur që kjo procedurë është e vitit 2022 dhe duke e ditur që është karakterizuar si kontratë shumë vjeçare, është parë shumë qartë: **Tabelat e Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla. Pra, kur procedura është inicuar në platformë ka pas mjete të mjaftueshme për vazhdimin me procedurë. Kjo dispozitë është e terhequr nga**

Rregullorja e re, konkretisht neni 5, pika 5.9.

Pretendimi numër 2.

Asnjeri nga Legjislacioni Primar / as Sekondar në fuqi dhe i shfuqizuar:

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ka hyrë në fuqi me datë 01.11.2022

RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK janar 2021, e shfuqizuar me datë 01.11.2022

Nuk paraqet asnjë dëshmi të vetme nëse anulimi i një procedure mund dhe varet mbi devijimet buxhetore pasi që AK ka krijuar obligim ndaj Operatoreve Ekonomik, konkretisht pas vendimit të OSHP-së për kthimin e lëndës në rivlerësim.

Po ashtu, për t'u bindur që AK ka vepruar në kundershtim të plotë me LPP-në i njejti edhe pas vendimit të OSHP-së ka kërkuar nga të gjithë Operatoret Ekonomik, vazhdimin e vlefshmerisë se tenderit, pra, duke e ditur që një procedurë të tillë ka pas për t'a anuluar i njejti nuk do të duhej të kërkonte vazhdimin e vlefshmerisë se tenderit, por qëllimi kryesor i tyre është anulimi pa bazë dhe pa argumente mbi LPP dhe rregulloret tjera.

Në asnjë nga pretendimet e pikës 2, AK nuk kthen përgjigje. Analizo, i njejti thirret ne atë se një shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo kjo nuk mund të llogaritet shkelje ligjore sepse mungesa e fondeve (nuk do të thot mos realizim / sigurim i fondeve në të ardhmen).

Pretendimi numër 3.

3.1. Bazuar në arsyetimin e AK-AMMK, konkretisht vendimin e datës 10.03.2023, duke u mbeshtetur në Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, konkretisht Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet

të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit, ***edhe ky është një pretendim tjetër i pabazuar nga ana e AK, pasi që AK i ka shterrur të gjitha mundësitë, ka dal me rezultate edhe gjatë vitit 2022, duke i pas të gjitha këto mjete në dispozicion, ka pranuar vendimin e OSHP-së që lëndën ta kthej në rivlerësim... duke e ditur që AK nuk po mund të kaloi të një OE i caktuar ka pretenduar me çdo kusht ta ndaloi një procedurë të tillë. Tani kjo po verifikohet.*** E vetmja shkelje ligjore këtu është mos respektimi i afateve kohore nga AK-AMMK për kthimin e lëndës në rivlerësim, duke e paraqitur vendimin e PSH-OSHP në Gjykatën Kompetente, ku siç po shihet përderisa AK-AMMK ka dal me Njoftimin mbi vendimin e AK, Gjykata e paska verifikuar vendimin e OSHP-së *(ky pretendim është i hamendesuar, për faktin që ne nuk kemi hasur në një vendim të tillë).*

Në asnjë nga pretendimet e pikës 3, AK nuk kthen përgjigje. Analizo, i njejti thirret ne atë se një shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo kjo nuk mund të llogaritet shkelje ligjore sepse mungesa e fondeve (nuk do të thot mos realizim / sigurim i fondeve në të ardhmen).

Pretendimi numër 4.

4.1. Një procedurë e prokurimit është e bazuar në Ligjin për Buxhet për vitin kur niset procedura dhe në rastin kur është kornizë një gje e tillë shkon me dy vitet pasuese apo me Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve, kur procedura është inicuar në platformë mjete ka pas, dhe duke e ditur që AK nuk po mund ta përfundoi një procedurë para fundit të vitit kalendarik këtë shumë është dashur ta bartë në vitin 2023. **Një gje të tillë mund edhe ta bartë në Qershorin e 2023 kur ndodh Ri-alokimi i mjeteve apo Ridestinimi financiar brenda kategorive buxhetore. Një procedurë e prokurimit edhe mund të nënshkruhet përderisa janë 1,790,000.00 Euro në KASH (Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve) / apo me mirë të themi rreth 94% e buxhetit të ofertës sonë.** Kjo çështje mund të rregullohet për 36 muajt e paraparë për realizimin e kontratës, pasi që ka afate kohore çdo vit, për ridestinim, rialokim dhe për ndarje të reja buxhetore në Kuvendin e Republikës se Kosovës, kur dihet që projekti është i një rëndësie të veçantë.

4.2. AK nuk ka ofruar asnjë dëshmi të vetme, nëse për projektin në fjalë ka kërkuar nga ZKA ose ZKF i AK, ose i Ministrisë se Kulturës, Rinisë dhe Sportit (pasi që në Ligjin për Buxhet janë pjesë e kësaj Ministrie) nëse ka ose mund të sigurohet diferenca. I njejti nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka kërkuar buxhet shtesë në Ministrinë e Financave dhe Transfereve apo ndonje organizatë tjetër kompetente lidhur me sigurimin e buxhetit, konkretisht Qeveria e Kosovës.

4.3. Se pretendimi i AK është tejet i pabazuar është për faktin që Oferta me e lirë brenda kësaj procedure është 1697198.48 apo me mirë të themi rreth 100,000 me pak se sa vlera e KASH-it. Edhe këtij OE, PSH-OSHP i ka dhënë të drejt në disa pretendime ku AK do të duhej t'i kërkonte përmes Nenit 72 të LPP-së. Pra, AK me çdo kusht është duke tentuar anulimin e procedurës vetem

se të njejten ta ndaj me faza dhe t'i favorizoi Operatoret Ekonomik të caktuar.

Në asnjë nga pretendimet e pikës 3, AK nuk kthen përgjigje. Analizo, i njejti thirret ne atë se një shkelje e ligjit ka ndodhur, mirëpo kjo nuk mund të llogaritet shkelje ligjore sepse mungesa e fondeve (nuk do të thot mos realizim / sigurim i fondeve në të ardhmen). I njejti paraqet se Autoriteti Konktraktues eshte fuzionuar në MKRS mirepo nuk ka jap asnje sqarim ose nuk ka paraqitur asnje kerkese nga MKRS nese i njejti ka kerkuar fonde shtese nga MKRS ose nga Qeveria e Kosoves. I njejti ne kete faze ka per qellim anulimin e teresishem te procedurës (per faktin e vetem qe i vetmi Operator Ekonomik i përgjegjshem jemi ne dhe në rastin konkret / nuk deshiron që neve si OE të na shperblei me kontratë).

Pjesa e dytë: Eliminimi edhe Operatoreve të tjerë ekonomik (konkretisht Operatoreve 1 - Grupi i Operatoreve Ekonomik SHKEMBI GLLAREVE SH.P.K; AD-STAR SHPK; BENI COM SH.P.K. PRO&CO GROUP, KLINË 32000, DRESNIK, nuk plotëson:, 2 dhe 3 në listë, të njejtit janë përjashtuar nga konkurimi me vendimin e Panelit Shqyrtues, andaj pretendimet i paraqesim vetem për Operatorin 1 / i renditur si OE me i lirë).

Duke e ditur që AK nuk ka ofruar asnjë dëshmi nëse i njejti ka vazhduar Validitetin e Ofertës, si Grup i Operatorëve Ekonomik LIMITPROJECT SH.P.K.; BM Group SH.P.K.; N.T. „Fer-Petroll, Skenderbeu Q.Zej.E-3-5, ., 13000, Gllogoc, Kosovë, pretendojmë Grupi i Operatoreve Ekonomik SHKEMBI GLLAREVE SH.P.K; AD-STAR SHPK; BENI COM SH.P.K. PRO&CO GROUP, KLINË 32000, DRESNIK, është i papërgjegjshem:

Kërkesa 4. OE duhet të ketë certifikatat a. Çertifikate ISO 9001-2015 b. Çertifikate ISO 14001-2015 c. Çertifikate ISO 45001 2018 d. Çertifikate ISO 28841–2013 e. Çertifikate ISO 39001-2012 f. Çertifikata ISO 50001-2018 g. Çertifikata ISO 3834-2– 2005 h. Çertifikata ISO 56003 – 2019, Evidenca 4 Kopjet e certifikatave te vlefshme për secilën dhe te noterizuara nga origjinali. Arsyetimi për mos plotësim: Të gjitha ISO Standardet jane te paraqitura për kompaninë AD Star nga Shqiperia, asnjeri prej tyre nuk verifikohet sipas QR linkut të paraqitur asnje nga ISOt e paraqitura ne liste nuk janë në noterizuar ne perputhje me kerkesen e Autoritetit Kontraktues.

- **Kjo çështje është e verifikuar edhe me vendimin e PSH-OSHP 698/710/22 të datës 01.02.2023.**
- **Lidhur me çështjen e caktuar, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim.**

Kërkesa 3 – Pjesa 5 . Një Inxh. i dipl. i Ndertimtarise drejtimi Hidro -5 vite përvojë pune pas diplomimit; Arsyetimi për mos plotësim: Personi i paraqitur në listë si Ing. i Hidrosë z. Alfred

Coma nuk është paraqitur kontrata.

- **Kjo çështje është e verifikuar edhe me vendimin e PSH-OSHP 698/710/22 të datës 01.02.2023.**

Lidhur me çështjen e caktuar, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim.

Kërkesa 3 – Pjesa 8. Dy (2) Teknik të ndërtimtarisë; Arsyetimi për mos plotësim: I angazhuari në poziten e teknikut te ndertimtaris Vahid Kryeziu – nuk ka prezantuar diplomen e teknikut, ka prezantuar Bachelor i Ndertimtarise dhe nuk eshte në përputhje me kërkesen e Autoritetit Kontraktues.

- **Kjo çështje është e verifikuar edhe me vendimin e PSH-OSHP 698/710/22 të datës 01.02.2023.**

- **Lidhur me çështjen e caktuar, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim.**

Kërkesa 5. Raportin për mjetet dhe pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e projektit. Grupi i Operatoreve Ekonomik SHKEMBI GLLAREVE SH.P.K; AD-STAR SHPK; BENI COM SH.P.K. PRO&CO GROUP, KLINË 32000, DRESNIK, nuk i plotëson kërkesat e AK (në disa nga pajisjet e paraqitura) Arsyet për mos plotësim:

8.1. Pajisja 6.2. Së paku një kamion kiper prej së paku 40 ton, asnjë dokument i prezantuar nuk e plotëson këtë kriter (eshte paraqitur ne fotografi nje Damper qe as nuk e ploteson kete kriter por as qe deshmohet me asnje dokument tjeter sipas kriterit);

8.2. Pajisja 6.6. Asnjë cilindër me rrota hekuri me vibrim nuk duket në foto e as nuk është i paraqitur me dokumentacionin tjetër përcjellës.

8.3. Pajisja 6.13. Nuk është e paraqitur as në listë dhe as në dokumentacionet tjera përcjellëse.

- **Kjo çështje është e verifikuar edhe me vendimin e PSH-OSHP 698/710/22 të datës 01.02.2023.**

Lidhur me çështjen e caktuar, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim.

- **Kjo çështje është e verifikuar edhe me vendimin e PSH-OSHP 698/710/22 të datës 01.02.2023.**

- **Lidhur me çështjen e caktuar, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje në Kërkesën për rishqyrtim.**

Si Operator Ekonomik hedhim dyshime se kompania SHKEMBI GLLAREVE SHPK ka paraqit dokumente fiktive, kjo për faktin se Fatura e lëshuar nga Albakos SH.P.K. me numër 02082022 – të datës 02.02.2022 – dhe fatura nr. 12082022 e dates 12.08.2022, paraqesin një aspekt të paqartë: Shitësi ALBAKOS SHPK me numër fiskal 600767646, në kontrollë në ARBK del se eshte numri i kompanisë SHKEMBI GLLAREVE SHPK (pranoni detajet):

SHKËMBI-GLLAREVË SH.P.K.

Emri i biznesit	SHKËMBI-GLLAREVË SH.P.K.
Emri tregtar	///
Lloji biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Numri unik identifikues	811242487
Numri i biznesit	70513544
Numri fiskal	600767646
Numri certifikues KTA	///
Numri punëtorëve	4
Data e regjistrimit	11/07/2008
Komuna	Klinë
Adresa	
Telefoni	+38345333352
E-mail	///
Kapitali	49,500.00€
Statusi në ARBK	Regjistruar
Statusi në ATK	///

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Në këtë fazë të ankesës nuk ka deme materiale të shkaktuara!

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*